



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

of the IPA CBC Programmes
Montenegro-Albania and
Montenegro-Kosovo 2014-2020 and
2021-2027

Prill 2025

FORUMI PËR KËRKIMIN E PROJEKT-PARTNERËVE NË KUADËR TË PROGRAMIT IPA III MALI I ZI – SHQIPËRI - SHKODËR

PËRMBAJTJA

Edicioni i njzetë e dy i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020 dhe 2021-2027. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian. Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA III BNK Mal i Zi - Shqipëri

2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në zonën ndërkufitare të programit nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA III BNK Mal i Zi- Kosovë

2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të zonës ndërkufitare të programit duke përmirësuar punësimin, lëvizshmërinë e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përmjet kufijve; dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKSKB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- Mbahet Forumi për Kërkimin e Projekt-partnerëve në kuadër të Programit IPA III Mali i Zi – Shqipëri2
- Ambasadori Satler vizitoi Plavën.....3
- Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të dhe të IV-të të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri3
- Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë7
- Ndërtimi i kapaciteteve për përfituesit e projekteve.....9
- Aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve për aplikantët potencialë brenda IPA III Mali i Zi – Shqipëri.....10
- Takimi i 5-të Rajonal i Sekretariateve të Përbashkëta Teknike IPA-IPA.....10

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

CBC ZOOM

Mbahet Forumi për Kërkimin e Projekt-partnerëve në kuadër të Programit IPA III Mali i Zi - Shqipëri

Më 14 shkurt të vitit 2025, në Shkodër u organizua një forum për ngritjen e partneriteteve për projekte në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë për periudhën 2021–2027.

Më shumë se 120 pjesëmarrës, përfaqësues të organizatave, institucioneve dhe kompanive nga të dy vendet, patën mundësinë të vendosin kontakte, të shkëmbejnë ide dhe të eksplorojnë mundësitë për bashkëpunim ndërkufitar. Forumi rezultoi në krijimin e partneriteteve të reja, ide inovative për projekte dhe baza të forta për nisma të ardhshme që do të sjellin përfitime për të dy vendet.

Nada Pejoviq, Drejtoreshë e Drejtorisë për Programet Ndërkufitare në Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti si fillimi zyrtar i Programit IPA III.

Bilaterale



Ajo kujtoi se bashkëpunimi mes dy vendeve ka nisur që në vitin 2008 përmes Programeve IPA I dhe II, gjatë të cilave janë zbatuar mbi 49 projekte me një vlerë mbi 13.9 milionë euro, në fusha si zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit, kohezioni social dhe infrastruktura.



Siç theksoi ajo, përmes bashkëpunimit me partnerët shqiptarë dhe me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, janë siguruar 11.9 milionë euro për fazën e re të Programit IPA III. Këto fonde do të orientohen drejt projekteve që promovojnë qëndrueshmërinë, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e turizmit dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Ajo shtoi se thirrja e parë për propozime pritet të publikohet së shpejti. "Projektet e zbatuara në kuadër të Programeve IPA I dhe II janë dëshmi e qartë e mënyrës se si bashkëpunimi evropian sjell rezultate konkrete. Kjo reflektohet në interesin e vazhdueshëm të përfituesve për të zhvilluar dhe zbatuar nisma të përbashkëta. Aktiviteti i sotshëm, përbën një hap tjetër përpara në këtë drejtim. Jam e bindur se deri në fund të këtij forumi do të krijojmë partneritete të reja dhe do të gjenerojmë ide të freskëta për përmirësimin e cilësisë së jetës në rajonin tonë ndërkufitar," theksoi **Pejoviq**.



Valbona Kosova nga Agjencia Shtetërore për Programim Strategjik dhe Koordinim të Ndihmës e Republikës së Shqipërisë shprehu mirënjohje për pjesëmarrësit për interesimin e madh ndaj projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar, duke theksuar se një entuziazëm i tillë është një nxitje kyçe për bashkëpunimin e suksesshëm rajonal. Ajo theksoi rëndësinë e aktiviteteve si ky forum për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë, besimin dhe partneritetet afatgjata ndërmjet institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile nga Shqipëria dhe Mali i Zi. **Kosova** vlerësoi gatishmërinë e pjesëmarrësve për të angazhuar në dialog

kuptimplotë, për të ndarë përvoja dhe për të eksploruar zgjidhje të përbashkëta për sfidat e përbashkëta të rajonit ndërkufitar. Ajo gjithashtu theksoi se gatishmëria për bashkëpunim përtej kufijve pasqyron një përkushtim të përbashkët për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim evropian, duke inkurajuar të gjithë të pranishmit që të vazhdojnë të ndërtojnë mbi këtë vull përmes nismave konkrete në kuadër të Programit IPA III.

Sanja Todoroviq, Shefe e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, prezantoi Programin e ri të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III Mali i Zi - Shqipëri, duke përfshirë mundësitë që ai ofron, informacionet kyçe mbi bashkëpunimin në projekte, si dhe një përmbledhje të paketës së aplikimit.



Më pas, pjesëmarrësit patën mundësinë të marrin pjesë në punëtori tematike të fokusuara në mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe në turizëm dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Forumi përfundoi me sukses, me një qëllim të qartë për të forcuar bashkëpunimin dhe krijimin e projekteve që do të kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të qëndrueshëm të rajonit ndërkufitar.



Ambasadori Satler vizitoi Plavën

Si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të mbështetur zhvillimin rajonal dhe qëndrueshmërinë mjedisore, Ambasadori i Bashkimit Evropian, Johan Sattler, vizitoi Plavën (Mal të Zi), për t'u njohur më nga afër me projektet që po zbatohen nga komunat në veri, përfshirë edhe projektet e financuara në kuadër të IPA Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri dhe ndikimin pozitiv që ato kanë në komunitetet lokale.

Gjatë vizitës së tij, Ambasadori Satler u njoh me projektin "Promovimi i Përdorimit të Qëndrueshëm të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike për

Përmirësimin e Jetesës dhe Ruajtjen e Biodiversitetit". Kjo nismë, e bashkëfinancuar përmes programit Mali i Zi - Shqipëri, synon të përmirësojë mundësitë ekonomike në zonat rurale, duke ruajtur njëkohësisht trashëgiminë natyrore të pasur të rajonit.



Përveç diskutimeve mbi projektin, Ambasadori zhvilloi takime me aktorë lokalë të rëndësishëm për të shqyrtuar tema më të gjera si zhvillimi i infrastrukturës, mbrojtja e mjedisit dhe bashkëpunimi i ardhshëm ndërkufitar. Vizita e tij nënvizon përkushtimin e vazhdueshëm të BE-së për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të udhëhequr nga komuniteti në rajonin ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të dhe të IV-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Sesione mentorimi në kuadër të projektit Pa Kufij për Punë!

Projekti *Pa Kufij për Punë!* po mbështet në mënyrë aktive sipërmarrësit vendas në Fushë-Arrëz përmes sesioneve të vazhdueshme të mentorimit të mbushura me pozitivitet dhe vlerë praktike. Këto sesione synojnë të forcojnë kapacitetet e bizneseve vendase duke ofruar mbështetje të përshtatur në fusha të tilla si përputhshmëria ligjore, administrimi financiar dhe menaxhimi efektiv i biznesit. Sipërmarrësit gjithashtu po fitojnë mjete për të përballuar sfidat e tregut të punës dhe për të menaxhuar krizat e papritura, duke i ndihmuar ata të qëndrojnë konkurrues në një mjedis ekonomik që ndryshon me shpejtësi. Me një kombinim të mentorimit individual dhe në grup, iniciativa po nxit një komunitet biznesi bashkëpunues dhe elastik, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e rajonit.

Projekti po zbatohet nga Kryeqyteti i Vjetër Mbretëror i Cetinës në bashkëpunim me OJQ-në ProAct Hub nga Podgorica, Bashkinë e Fushë-Arrëzit dhe Institutin për Politika të Qëndrueshme nga Shqipëria, dhe ka për qëllim promovimin e punësimit dhe zhvillimit ekonomik gjithëpërfshirës social.



Seminari mbi interpretimin e itinerarit kulturor u mbajt në Qytetin e Vjetër të Tivarit

Seminari Interpretimi i Itinerarit Kulturor të Rivitalizuar të Qytetit të Vjetër të Tivarit dhe Tropojës u mbajt me sukses në Qendrën Kreative në Qytetin e Vjetër të Tivarit (Mali i Zi). Eventi mbledhi 20 pjesëmarrës, përfshirë guida turistike dhe profesionistë të trashëgimisë kulturore.



Seminari, i organizuar në kuadër të projektit *Realitet i Ri për Sitet e Trashëgimisë*, u përqendrua në përmirësimin e interpretimit dhe prezantimit turistik të itinerareve kulturore të rivitalizuara. Arkeologët e nderuar Goran Pajović dhe Dejan Drashković drejtuan sesione informuese që mbulonin rëndësinë historike dhe kulturore të Qytetit të Vjetër, si dhe fakte dhe histori interesante të lidhura me monumentet kryesore.

Gjithashtu, pjesëmarrësve iu prezantua një hartë dhe një aplikacion celular i zhvilluar rishtazi, të dyja të dizajnuara për të përmirësuar përvojën e vizitorëve. Seminari përfundoi me një turne me guidë nëpër Qytetin e Vjetër, duke u ofruar pjesëmarrësve mundësinë për të eksploruar vendin nga afër së bashku me arkeologë ekspertë. Eventi i fuqizoi me sukses palët e interesuara për të kontribuar në një interpretim më tërheqës dhe informues të trashëgimisë kulturore në rajon.




Për më tepër, si pjesë e aktiviteteve të projektit, në Tropoje u vendos sinjalistika vertikale.



Së fundmi, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të pasuruar përvojat e vizitorëve, Komuna e Tivarit ka lançuar një aplikacion hartash dixhitale që tani është i disponueshëm në Google Play nën emrin [Harta e Qytetit të Vjetër të Tivarit](#).

Ky aplikacion interaktiv është i bazuar ngushtësisht në itinerarin e rigjallëruar të rrugës kulturore dhe është përshtatur për përdorim online. Ai përmban një shfaqje grafike të detajuar të Qytetit të Vjetër të Tivarit, duke përfshirë të gjitha ndërtesat historike dhe rrugët e lëvizjes të shënuara qartë.

Aplikacioni u ofron përdoruesve shpjegime tekstuale informative për vendet kryesore, duke e bërë atë një mjet të vlefshëm si për turistët ashtu edhe për guidat.



Konferenca përfundimtare e projektit Aftësi për Punë - Mali i Zi - Shqipëri

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit *Aftësi për Punë të Qëndrueshme dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punë Shqipëri – Mali i Zi*, në bashkëpunim me Fondacionin Business Start Center dhe Dhomën e Ekonomisë së Malit të Zi, organizoi

konferencën përmbyllëse të projektit në Shkodër, më 22 janar të vitit 2025.

Pjesëmarrësit në konferencë ishin përfaqësues nga Bashkia e Shkodrës, Vau i Dejës dhe Malësia e Madhe. Ky aktivitet përmbyllës shënoi përfundimin me sukses të projektit ndërkufitar, i cili është zbatuar për 22 muaj në zonën ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Përfaqësuesit prezantuan rezultatet e arritura nga projekti, si dhe vazhdimin e nismave të përbashkëta të bashkëpunimit për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të forcuar lidhjet ekonomike midis dy vendeve.



Ndërtimi i kapaciteteve për ekipet e zjarrfikjes

Gjatë prillit të vitit 2025, në Tivar të Malit të Zi u zhvillua një aktivitet për ngritjen e kapaciteteve për ekipet e zjarrfikjes të Bashkisë Shkodër dhe Komunes së Tivarit, në kuadër të projektit *Ndërtimi i Pyje të Zgjuar*.



Trajnimi synonte rritjen e kapaciteteve të reagimit në situata emergjente dhe shkëmbimin e përvojave midis ekipeve për shuarjen e zjarreve në pyje. Trajnimi përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit për menaxhimin efikas të zjarreve në pyje në zonat ndërkufitare të Shkodrës dhe Tivarit.



Ky trajnim kontribui në rritjen e profesionalizmit dhe shkëmbimin e përvojave midis ekipeve të zjarrfikjes, ndërtimin e një rrjeti të fortë të bashkëpunimit teknik dhe njerëzor, njohjen me teknologjitë moderne të zjarrfikjes dhe sigurimin e një reagimi më të shpejtë dhe më efikas në rastet kur situatat emergjente kalojnë kufijtë.

Përveç pjesës teorike, gjatë trajnimit u zhvilluan ushtrime në kohë reale, ku ekipet e zjarrfikjes nga të dy bashkitë bashkëpunuan në skenarë kompleks emergjence. Pjesëmarrësit patën mundësinë të punonin krah për krah, duke ndërtuar besim, duke ndarë përvoja dhe duke ndërtuar kapacitete për t'u përballur me çdo sfidë.




Përmes ushtrimeve praktike dhe diskutimeve profesionale, ky trajnim kontribui në bashkëpunimin dhe rritjen e gatishmërisë dhe efikasitetit të ekipeve të zjarrfikjes në të dy bashkitë.

Iniciativa për Rezervën Ndërkufitare të Biosferës së Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës

Projekti *Pellgu ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës - Një Rezervë Biosfere Ndërkufitare* synon të sjellë ndikim pozitiv në ekosistemin e rëndësishëm ndërkufitar të ndarë midis Shqipërisë dhe Malit të Zi për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe bashkëpunuese zonën në dobi të komuniteteve dhe vetë natyrës, në përputhje me kushtet e Programit të UNESCO-s Njeriu dhe Biosfera.

Shikoni videon promovuese [këtu](#).



Projekti zbatohet nga Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzimin (qendra EDEN), Programi Mjedisor - EnvPro, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri dhe Ndërmarrja Publike e Parqeve Kombëtare të Malit të Zi.

Lançimi i projektit ndërkufitar të punësimit për të rinjtë dhe të papunët

Më 6 mars të vitit 2025, Lezha priti lançimin zyrtar të projektit të financuar nga BE-ja "Nxitja e punësimit të denjë për të rinjtë dhe personat e papunë në zonën ndërkufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë". Iniciativa synon fuqizimin e të rinjve dhe individëve të papunë përmes aftësive të buta dhe trajnimit dixhital, praktikave profesionale dhe mbështetjes sipërmarrëse.

I zbatuar nga World Vision Albania, Agjencia e Punësimit e Malit të Zi dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të Shqipërisë, projekti do të mbështesë 30 nxënës të shkollave profesionale, 140 të rinj të papunë dhe 40 artizanë gra dhe burra zejtarë në ekonomitë familjare.



Eventi i lançimit mbledhi së bashku palët e interesuara për t'u përfshirë me qëllimet dhe për të forcuar bashkëpunimin për rezultate me ndikim.



Lançohet zyrtarisht në Ulqin projekti ndërkufitar për zhvillimin e sipërmarrjes së grave

Më 12 shkurt të vitit 2025, në Ulqin, u lançua zyrtarisht projekti "Zhvillimi i mikro-ndërmarrjeve të grave në zonën ndërkufitare". Qëllimi i projektit është fuqizimi i grave sipërmarrëse dhe kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në rajonet kufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Kjo iniciativë ndërkufitare mbështetet përmes Thirrjes së Katërt të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II Mali i Zi - Shqipëria 2014–2020 mbrenda seciles janë ndarë fondedt prej 1.5 milion eurosh.



Nada Pejoviq, Drejtoreshë e Drejtorisë për Programet Ndërkufitare Bilaterale në Ministrinë e Çështjeve Evropiane, theksoi rëndësinë e kësaj iniciative, duke deklaruar se projekti do t'u mundësojë grave të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit, të rrisin njohuritë e tyre dhe të hyjnë në tregje me mbështetjen e nevojshme. "Projekti jo vetëm që inkurajon rritjen ekonomike, por gjithashtu kontribuon në dukshmërinë dhe promovimin më të madh të sipërmarrjes së grave. Duke forcuar aftësitë sipërmarrëse dhe duke krijuar shërbime këshillimi për biznes, ne po ofrojmë mundësi konkrete për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të udhëhequra nga gratë. Ministria e Çështjeve Evropiane, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, do të vazhdojë të mbështesë projekte të tilla që kontribuojnë në prosperitetin e rajonit ndërkufitar dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë së tij", vuri në dukje **Pejoviq**.

Kryetari i Komunes së Ulqinit, **Genci Nimanbegu**, falënderoi partnerët nga Ulqini dhe Shqipëria për përkushtimin e tyre, duke theksuar se projekti përqendrohet te gratë, fuqizimi i tyre dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së tyre përmes mbështetjes për bizneset e qëndrueshme.



Sanja Todoroviq, Kryetare e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, shprehu kënaqësinë për mbështetjen e vazhdueshme për sipërmarrjen e grave, duke vënë në dukje se projekti është një shembull i praktikave më të mira në përdorimin e fondeve të BE-së dhe në forcimin e kapaciteteve të partnerëve lokalë.

Përveç mbështetjes së sipërmarrjes së grave, bashkëpunimi ndërkufitar do të vazhdojë përmes Programit të ri IPA III Mali i Zi - Shqipëria për periudhën 2021–2027, me një buxhet total prej 13.79 milionë eurosh.

Programi do të përqendrohet në qëndrueshmërinë mjedisore, zhvillimin e turizmit dhe forcimin e konkurrueshmërisë.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Përfundimi i suksesshëm i projektit NERA

Më 28 mars të vitit 2025, projekti NERA – Qasja e Re për Revitalizimin e Mjedisit, i zbatuar në bashkëpunim ndërmjet Komunës së Tuzit dhe Komunës së Pejës, përfundoi zyrtarisht me një konferencë përmbyllëse të mbajtur në Pejë.

Ngjarja mbledhi përfaqësues nga të dyja komunat, partnerët e projektit dhe anëtarë të komunitetit për të festuar arritjet dhe ndikimin e këtij bashkëpunimi ndërkombëtar.



Ndiqui [fagen e projektit](#) për më shumë përditësime dhe informacione mbi rezultatet e arritura.



Konferencë e mbajtur në Kolashin

Gjatë muajit mars të vitit 2025, në Kolashin u mbajt një konferencë dyditore me temën *Përmirësimi i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta*, e organizuar në kuadër të projektit “Marrëveshja e Gjellbër Ndërkufitare”, i cili zbatohet nga FORS Mali i Zi, ECMI Kosova dhe Komuna e Beranes. Qëllimi i konferencës ishte shkëmbimi i përvojave, opinionëve, modeleve të praktikave të mira dhe mësimëve të nxjerra në fushën e menaxhimit të mbeturinave të ngurta, si dhe rritja e ndërgjegjësimit për këtë çështje dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.



Konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve dhe shërbimeve që merren me mbrojtjen e mjedisit, organizatave të shoqërisë civile, qeverive kombëtare dhe lokale, mediave, etj., nga Mali i Zi dhe vende të tjera. Temat që u diskutuan më në detaje gjatë konferencës përfshinin strategjitë dhe politikat në fushën e menaxhimit të mbeturinave, sfidat kryesore, shembujt e praktikave të mira dhe teknologjitë e reja, menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave të ngurta, zbatimin e projekteve në këtë fushë, si dhe edukimin për menaxhim të duhur të mbeturinave.



Projekti “Marrëveshja e Gjellbër Ndërkufitare” synon përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në sektorët e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave, si dhe ngritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e sjelljes së përgjegjshme ndaj mjedisit në ruajtjen e ambientit dhe burimeve natyrore.

Certifikohet gjenerata e re e Auditorëve të Eko-Etiketës

Në një hap të rëndësishëm drejt promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm në sektorin e turizmit, projekti *Turizmi për të Ardhmen* ka certifikuar me krenari 15 auditorë të rinj të Eko-Etiketës (Eco-label). Këta profesionistë, tashmë të pajisur zyrtarisht me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të vlerësuar dhe udhëzuar bizneset turistike drejt certifikimit ekologjik, do të luajnë një rol thelbësor në ndërtimin e një të ardhmeje të gjellbër për turizmin në rajon. Çertifikimi i tyre shënon një arritje të rëndësishme në nxitjen e udhëtimit me përgjegjësi mjedisore,

promovimin e praktikave të gjelbra dhe inkurajimin e bashkëpunimit ndërkufitar në turizëm në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Procesi i certifikimit u zhvillua përmes moduleve intensive të trajnimit, të fokusuar në kriteret e eko-etiketës, proceset e auditimit dhe parimet e qëndrueshmërisë, të përshtatura për veçoritë ekologjike dhe kulturore të rajonit.



Ceremonia e Hapjes së Qendrës Kreative “Dukagjini”

Më 12 shkurt të vitit 2025 u mbajt ceremonia e hapjes së Qendrës Kreative “Dukagjini”, e cila ndodhet në Pejë, Kosovë. Kjo qendër është themeluar si një hapësirë për kreativitet, duke forcuar rolin e trashëgimisë kulturore në zhvillimin e qëndrueshëm. Me udhëzimin dhe mbështetjen e Qendrës Kreative në Tivar, Mali i Zi, kjo hapësirë është shndërruar në një model të bashkëpunimit ndërkufitar, duke kombinuar burimet dhe njohuritë për të nxitur zhvillimin rajonal.



Krijimi dhe zhvillimi i kësaj qendre janë zbatuar nga CHwB Kosova në kuadër të projektit C.L.O.S.E.R., i cili po realizohet në bashkëpunim me Komunën e Tivarit.



Panairi Ndërkufitar i Biznesit nxit bashkëpunimin rajonal ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës

Në kuadër të projektit *Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës – Pa Kufij!*, në qytetin e Pejës u mbajt me sukses një Panair Ndërkufitar i Biznesit, duke bashkuar 21 biznese nga komunat në të dy anët e kufirit në Mal të Zi dhe Kosovë. Ky aktivitet shërbeu si një platformë e rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit ekonomik, nxitjen e partneriteteve dhe promovimin e tregtisë rajonale. Me një vizion të përbashkët për të kapërcyer barrierat dhe ndërtuar lidhje të qëndrueshme, biznese nga sektorë të ndryshëm prezantuan produktet dhe shërbimet e tyre, eksploruan tregje të reja dhe morën pjesë në aktivitete të vlefshme rrjetëzimi me synim zgjerimin e veprimtarisë përtej kufijve kombëtarë.



Panairi u shoqërua edhe me mbajtjen e konferencës përmbyllëse të projektit *Pa Kufij*, e cila vuri në pah ndikimin konkret të projektit, veçanërisht në fuqizimin e të rinjve dhe mbështetjen e bizneseve lokale përmes nismave për ngritje kapacitetesh. Projekti u zbatua nga Oda Ekonomike e Malit të Zi, Oda e Tregtisë e Republikës së Kosovës, Qendra Rajonale e Biznesit Berane dhe Instituti për Edukim, Trajnim dhe Kërkime nga Kosova.



Konferenca përmbyllëse e projektit “Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore” u mbajt në Berane

Konferenca përmbyllëse e projektit *“Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore – Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor”* u mbajt në Berane. Ky projekt, me një vlerë prej 400.000 euro, kishte për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë ekonomike të zonës ndërkufitare

ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës duke përmirësuar potencialin e saj për turizëm kulturor. Projekti u zbatua nga Muzeu i Polimljës në Berane dhe OJQ Marimangat e Pejës nga Kosova. Ngjarja dyditore mbledhi përfaqësues nga ministritë që merren me arkeologji, kulturë, shkencë, kërkime dhe turizëm, përfaqësues të qeverive lokale, shoqërisë civile, profesionistë të fushës së kulturës dhe turizmit, punonjës muzealë dhe palë të tjera të interesuara.



Në hapje të konferencës, **Violeta Foliq**, Drejtoreshë e Muzeut të Polimljës në Berane, falënderoi partnerët për bashkëpunimin efektiv. *"Ky projekt ka forcuar bashkëpunimin ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës në fushat e kulturës dhe turizmit, duke hapur gjithashtu rrugën për bashkëpunim në fusha të tjera"* tha **Foliq**. **Nada Pejoviq**, udhëheqëse e Drejtorisë për Programet Bilaterale Ndërkufitare në Ministrinë për Çështje Evropiane, theksoi vlerësimin e madh për përpjekjet e të gjithë përfituesve të projektit që punojnë për të përmirësuar konkurrueshmërinë ekonomike të rajoneve kufitare. *"Rezultatet e këtij projekti janë me rëndësi të madhe për rritjen e konkurrueshmërisë turistike të zonës ndërkufitare ndërmjet Beranës dhe Pejës përmes zhvillimit të kulturës dhe turizmit, si dhe përmes përdorimit të mjeteve shkencore moderne për studimin, ruajtjen dhe valorizimin e pasurive kulturore në këtë rajon"* theksoi **Pejoviq**.



Kryetari i Komunës së Beranës, **Gjole Lutovac**, përgëzoi partnerët për përkushtimin dhe bashkëpunimin e treguar në kuadër të projektit, si dhe për rezultatet e arritura. *"Jam i kënaqur që projekte të rëndësishme po zbatohen dhe investohen në veri të Malit të Zi. Komuna e Beranës do të mbështesë gjithmonë nisma të tilla për të zhvilluar dhe valorizuar së bashku potencialin tonë lokal"* deklaroi **Lutovac**. **Xheneta Syka Kelmendi**, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Sport dhe Rini në Komunën e Pejës, theksoi rëndësinë e këtij projekti për trashëgiminë kulturore të zonës ndërkufitare. *"Ky projekt ka kontribuar në promovimin e kulturës së Pejës dhe ka mundësuar valorizimin e trashëgimisë lokale për qëllime kulturore-turistike"* tha **Kelmendi**.

Sanja Todoroviq, udhëheqëse e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, deklaroi se përmes këtij projekti janë krijuar kushte për ruajtjen e pasurive të çmuara kulturore për gjeneratat e ardhshme. Kjo është arritur përmes gërmimeve dhe konservimit në lokalitetin Tumbarice, konservimit të Hamamit të Hadži Beut në Pejë, si dhe grumbullimit të një sasive të madhe të të dhënave dixhitale 3D nga burime të ndryshme, në rezolucion të lartë dhe me përmbytje më të pasur, si para ashtu edhe pas konservimit. *"Shpresoj që komunat ku ndodhen këto pasuri të trashëgimisë kulturore do të sigurojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit përmes investimeve të mëtejshme në valorizimin e tyre, përmirësimin e qasjes dhe promovimin e tyre. Kjo do të përmirësojë ofertën turistike dhe për rrjedhojë edhe situatën ekonomike të qytetarëve dhe komunave të tyre,"* shtoi **Todoroviq**. Projekti u përqendrua në lokalitetin arkeologjik Tumbarice në Berane dhe restaurimin e Hamamit Turk në Pejë. Këto vende janë konceptuar si qendra kryesore për kërkime, edukim dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Janë përdorur qasje moderne, përfshirë aplikimin e teknologjisë 3D, për të përpunuar, ruajtur dhe paraqitur të dhëna të zgjedhura mbi trashëgiminë kulturore të paluajtshme, duke ofruar kështu një platformë të fortë për kërkime të mëtejshme dhe ngritje të vetëdijes për rëndësinë e trashëgimisë kulturore për shoqërinë.

Ndërtimi i kapaciteteve për përfituesit e projekteve

Gjatë periudhës shkurt - prill 2025, Strukturat Operative me mbështetjen e SPT organizuan një seri ngjarjesh për ndërtimin e kapaciteteve për përfituesit e Thirrjes së 4-t për Projekte Mali i Zi - Shqipëri.



Në veçanti, SPT ofroi ndihmë administrative dhe teknike për CFCU-në dhe ekspertin e jashtëm për Trajnimin mbi prokurimin sekondar dhe Seminarin e Zbatimit që u zhvillua në Podgoricë. Trajnimi u përqendrua në rregullat e prokurimit sekondar të BE-së dhe kërkesat e Aneksit IV të Kontratës së Grantit, si dhe në planifikimin dhe menaxhimin e projektit dhe monitorimin e brendshëm.



Trajnime mbi Raportimin dhe mbi Publicitetin dhe dukshmërinë për përfituesit u mbajt në Shkodër (Shqipëri).



SPT mbajti trajnimet ku përfituesve iu dhanë udhëzime të hollësishme mbi plotësimin e raportit të ndërmjetëm ose përfundimtar, si dhe informacion mbi metodat dhe teknikat e duhura për publicitet dhe dukshmëri në përputhje me rregullat e BE-së.



Aktivite për ndërtimin e kapaciteteve për aplikantët potencialë brenda IPA III Mali i Zi - Shqipëria

Sekretariati i Përbashkët Teknik, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, Ministrinë e Financave të Malit të Zi - Drejtorinë për Financimin, Kontraktim dhe Zbatimin e Fondeve të Ndihmës së BE-së (CFCU) dhe Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës së Republikës së Shqipërisë (SASPAC), organizuan trajnime tre-ditore mbi menaxhimin e ciklit të projektit për aplikantët potencialë nga zona e Programit të pranueshëm të Shqipërisë.



Gjatë muajit shkurt të vitit 2025, si pjesë e aktiviteteve përgatitore para publikimit të Thirrjes së Parë për Projekt-propozime brenda Programit IPA III BNK Mali i Zi - Shqipëri, u organizua një trajnim mbi hartimin e propozimeve të projektit në përputhje me rregullat e BE-së. Konkretisht, trajnimi iu dedikua aplikantëve të tjerë potencialë përveç autoriteteve lokale dhe rajonale nga Shqipëria dhe u mbajt në periudhën 3-5 shkurt të vitit 2025 në Shëngjin.

Takimi i 5-të Rajonal i Sekretariateve të Përbashkëta Teknike IPA-IPA

Nga data 8 deri më 10 prill të vitit 2025 në Shkup u mbajt Takimi i 5-të Rajonal i Sekretariateve të Përbashkëta Teknike IPA-IPA, i organizuar nga Cbib Plus.



Ngjarja mbledhi përfaqësues nga rajoni për të diskutuar rreth përdorimit të inteligjencës artificiale në komunikim, përmirësimeve në Sistemin e Monitorimit të IPA III, si dhe për të ndarë të rejat mbi zbatimin e programeve bilaterale IPA II dhe IPA III.



Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministarstvo
evropskih
poslova



Montenegro
Ministry of Finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra kryesore

Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Montenegro

Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik

E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat

E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ

E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Shkodër

Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri

Telefon: + 355 22 80 20 80;

Nersada MANDIJA

Zyrtare Projekti, Antenë

E-mail: nersada.mandija@saspac.gov.al

Sekretariati i Përbashkët Teknik – Zyra Antenë Prishtinë

Adresa: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kati

i 11-të, ish-ndërtesa Rilindja, 10 000, Prishtinë, Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë

E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



@cbc.mne.alb



@cbc_mne_alb



@cbc.mne.kos



@cbc_mne_kos

Cross-Border
Cooperation



Funded by
the European Union

Montenegro – Albania

Cross-Border
Cooperation



Funded by
the European Union

Montenegro – Kosovo